



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TROPOJË**



**RAPORT-VJETOR  
MBI GJËNDJEN E KRIMINALITETIT  
DHE VEPRIMTARINË E PROKURORISË PËR VITIN 2019**

TROPOJË 2020



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TROPOJË**

Ne Bajram Curri me date 22.02.2020

**RAPORT – VJETOR**

Mbi treguesit kryesore te punes, dhe ushtrimit te veprimtarise nga Prokuroria prane Gjykeses se Shkalles se Pare Tropoje, per vitin 2019.

**DREJTUAR;**

**PROKURORIT TE PERGJITHSHEM**  
**Z. OLSIAN CELA**

Raporti vjetor “Mbi gjendjen e kriminalitetit per vitin 2019”, perpilohet ne permbushje te nenit 50 te ligjit nr.97/2016 “Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise”, duke ja paraqitur Prokurorit te Pergjithshem per miratim.

Ne kete raport pasqyrohet ne menyre te plote e me realizem, gjendja e kriminalitetit, te dhena dhe shpjegime per numrin, llojin, shtrirjen, intensitetin dhe format e kriminalitetit ne juridiksionin e Prokurorise Tropoje, si dhe ne veshtrim te urdherit nr.26 date 12.02.2019 te Prokurorit te Pergjithshem, ku jane percaktuar drejtimet kryesore :

- Zbatimi i udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem (ne dinamike), me tregues dhe shpjegime per angazhimet e Prokurorise, arrijtet dhe problematikat.
- Zbatimi i Rezolutes “Per vleresimin e veprimtarise se organit te Prokurorise per vitin 2019” miratuar me date nga Kuvendi i Shqiperise.

Prokuroria e Rrethit Gjyqesore Tropoje ka ushtruar veprimtarine e saj ne respektim te dispozitave kushtetuese dhe ligjore (*ne vazhdimesi dhe perputhje dhe me ndryshimet ligjore te K.Pr.Penale*), si dhe ato qe burojne nga marreveshjet nderkombetare te ratifikuara me ligj nga Kuvendi i RSh, ne vleresim dhe te urdherave e udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem.

Ne ushtrim te detyrave dhe perballimin e ngarkeses gjate vitit 2019, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tropoje deri ne muajin tetor 2019, ka patur efektivisht ne perberje 2 prokurore dhe konkretisht prokuroret Artan Shtrungza dhe Artur Ismajlukaj, si dhe 1 oficer i policise gjyqesore. Nga muaji tetor 2019, ne Prokurorine Tropoje ushtron detyren dhe prokurori Agim Dalipi i cili deri ne kete date ka qene i komanduar ne Prokurorine Lezhe.



Por referuar dinamikës së punës në teresi, ngarkesës në hetim, por veçanërisht të asaj në gjykim, rastet e referuara janë trajtuar me kujdes dhe objektivitet, treguesit rezultojnë pozitiv në zgjidhjen e çështjeve si nga pikepamja profesionale, por dhe treguesve të tjerë, të shpejtesisë në hetim, politikave objektive dhe të drejta të raportit të të kesave të Prokurorisë dhe vendosjes së masave të sigurimit ndaj autoreve nga Gjykata, por dhe në aspektin e përfaqësimit në Gjykate të çështjeve, me qëndrimeve të mbajtura deri në masat e denimit, të përfaqësimeve në Gjykate.

Gjatë vitit 2019, duke pasqyruar të dhënat statistikore dhe krahasuar ato me vitin 2018 por dhe me vitet e mëparshme, rezultoi se ka pasur një zbutje të situatës së kriminalitetit në Bashkinë Tropojë, në të cilën ka juridiksion Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë.

Nga të dhënat statistikore vërehet se ka rritje të numrit të veprave penale kundër jetës dhe shëndetit, veprave penale në fushën e pasurisë dhe ekonomisë, veprave penale kundër mjedisit etj.

Për sa i përket luftës kundër kriminalitetit ka pasur një forcim të bashkëpunimit me strukturat e policisë së shtetit në Komisarjatin e Policisë Tropojë dhe Drejtorinë e Policisë Qarkut Kukës, si dhe SHÇBA me qëllim identifikimin e veprave penale, autoriteteve të tyre, kryerjen e veprimeve hetimore sa më të shpejta dhe efektive, identifikimin e fenomeneve të kriminalitetit, pjesëmarrjen e prokurorit në ngjarjet e rëndësishme kriminale dhe ato kur prania e tij është e domosdoshme, kryerjen e analizave të përbashkëta në lidhje me fenomene të caktuara kriminale siç janë ato të kultivimit të narkotikëve të cilat për vitin 2019, kanë qenë në një numër shumë të vogël dhe raste sporadike që kanë rezultuar pa ndonjë organizim të strukturuar të veprimtarisë kriminale, por me raste individuale të kultivimit në sasi shumë të vogla në krahasim me vitet e tjera.

Për sa i përket veprave penale me të mitur ka pasur raste të pakta të hetimeve me persona të dyshuar të mitur të cilat kanë qenë për vepra penale të parashikuara nga nenet 90 dhe 291 të Kodit Penal, për të cilat për shkak të numrit të vogël të prokurorëve dhe mungesës objektive për ngritjen e seksionit për të miturit, fillimisht janë transferuar për kompetencë lëndore në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkoder. Në çdo rast të kryesës së veprimeve hetimore të miturit janë asistuar me psikolge, avokat dhe familjare, duke respektuar të gjitha normat e përcaktuara ligjore të Kodit të Procedurës Penale dhe akteve nenligjore për të miturit.

Gjatë vitit 2019, ka pasur shtim të procedimeve penale të dërguara në gjykate me marrëveshje për pranimin e fajësive, si dhe me miratimin e urdherit penal të prokurorit. Po ashtu për vepra penale me masë të ulët denimi, për kundravajtje penale dhe persona me rrezikshmeri të ulët shoqërore, nga prokurorët janë kërkuar në gjykate kërkesa për denime alternative, ndërsa janë kërkuar masa të ashpra sigurimi për veprat penale në fushën e dhunës në familje, vepra penale në fushën e kultivimit apo trafikimit të narkotikëve, si dhe për vepra penale që cenojnë zgjedhjet e lira. Konkretisht në fushën e veprave penale që cenojnë zgjedhjet e lira është rregjistruar një procedim penal me 9 (nente) persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale "Dëmtim me dashje i materialit zgjedhësor", "Shkatërrim i pronës", "Kundershtim i punonjësit të policisë së rendit publik" dhe "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme", të parashikuara nga nenet 326/a, 150, 236 dhe 262 të Kodit Penal.



Po ashtu masa te ashpra sigurimi jane kerkuar edhe ndaj autoreve te veprave penale kunder jetes dhe pasurise, te cilat gjate kesaj periodhe kane qene ne numer me te ulet se vitet e tjera.

Per sa i perket rekomandimeve per bashkepunimin nder institucional ka pase permiresim te bashkepunimit me policine e shtetit ne luften kunder kriminalitetit duke perfshire dhe analiza per raste specifike apo dhe me natyre te pergjithshme, me Komisarjatin e Policise Tropoje, Drejtorise e Policise Kukes, Zyren e SHÇBA, te cilat kane rezultuar te dobishme ne ushtrimin e ndjekjes penale. Materialet hetimore jane derguar per hetim oficerëve te policie gjyqesore apo seksioneve qe kane referuar vepren penale, duke mbajtur kontakte te vashdueshme per kontrollimin e kryerjes se veprimeve hetimore te deleguara nga prokurori.

Gjate vitit 2019, eshte rritur aksesin ne te dhenat e databazeve shtetore per administrimin ne kohe te shpejte te te dhenave personale dhe informacioneve te tjera me qellim rritjen e shpejtesise dhe efikasitetin e hetimeve.

Po ashtu gjate ketij viti prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore kane ndjekur kurset e trajnimit te organizuara nga Shkolla e Magjistratures, Projekti IPA 2014, Projekti PAMECA VI etj.

**Analiza e punes se organit te Prokurorise ne pergjithesi dhe asaj ne vecanti te çdo Prokurori dhe Of/Pol/Gjyqesore, do ta realizonim duke ju referuar te dhenave statistikore 1-vjeçare qe analizojme pra vitit 2019.**

**I. Volumi i akteve te referuara (kallzime penale nga sherbimet e policise, nga Institucionet dhe qytetaret).**

Jane regjistruar (*protokolluar*) ne sekretarine e Prokurorise Tropoje, referime per vepra penale per vitin 2019, 272 materiale kallezuese, Nga keto 133 materiale kallezuese jane referuar nga sektoret e sherbimeve te Pol.Gjyqesore prane Komisarjatin te Policise Tropoje, 13-materiale kallzuese nga Institucionet, 126-materiale kallzuese nga qytetaret.

Ne krahasim me vitin e meparshem rezulton nje renie te materialeve kallezuese te referuara dhe rregjistruara ne prokurori ne krahasim me vitin 2018. Konkretisht gjate vitit 2018 jane rregjistruar 291 materiale kallezuese ne prokurori, ndersa gjate vitit 2019 272 materiale kallezuese, pra me nje renje te kallezimeve penale me 19 materiale kallezuese me pak krahasuar me vitin 2018.

**Evidence e Referimeve dhe kallzimeve te regjistruara ne Prokurori**

Viti	Referime nga sherbimet e policise	Kallzime nga Institucionet	Kallzime nga shtetasit dhe vepra mbi ankimin e te demtuarit	Gjithsej
2018	175	19	97	291
2019	133	13	126	272



Te gjitha rastet e akteve te referuara apo kallezimeve te paraqitura jane trajtuar me pergjegjesi, duke i evidentuar ne regjistrat perkates, duke marre vendime perkates ligjore, regjistrimi apo mosfillimi te ceshtjes penale sipas rastit.

Nga kallezimet penale dhe referimet e protokolluara ne sekretari dhe regjistrin perkates ne 88 – materiale kallezuese **eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal** ne baze te nenit 290/-291/ te K.Pr.Penale (3 vendime mosfillimi me shume se gjate viti 2018 ku eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal per 85 materiale kallezuese).

**Eshte vendosur regjistrimi i procedimit penal per 181 ceshtje penale** (19 procedime penale me pak se vitin 2018 gjate se cilit jane rregjistruar 200 procedime penale).

**Gjate vitit 2019 ka pase renje te procedime penale te rregjistruar me rreth 10%, krahasuar me vitin 2018.**

Viti	Referime kallzime	Mosfilluar	Regjistruar
2018	291	85	200
2019	272	88	181

Me qarte veprimtaria e Prokurorise do te rezultoj duke **analizuar treguesit sipas dinamikes se trajtimit gjate hetimeve dhe vendimarrjes** referuar dhe praktikes procedurale qe ndiqet, nga momenti i konstatimit te veprave penale nepermjet vend-ngjarjeve, kallzimeve penale etj, trajtimit ne aspektin ligjor, shpejtesise ne hetim etj, qe te krijonim nje tablo sa me te qarte te pasqyrimet te rezultateve apo mangesive dhe problematikave te evidentuara.

## **II. MOSFILLIMET**

Eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal ne baze te neneve 290/ dhe 291/ te K.Pr.Penale, per 88- materiale kallezuese.

Sa i perket tendences te natyres se veprave penale te referuara, ne numrin 88-te vendimeve te vendimeve te mosfillimit rezultojne ne numer te konsiderueshem si me poshte :

### **Veprat penale te drejtuara kunder jetes se personit dhe shendetit kreu II.**

Gjate vitit 2019 eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal per **30 materiale kallezuese.**

### **Vepra penale kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike kreu III.**

Gjate vitit 2019 eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal per **54 materiale kallezuese.**

### **Vepra penale kunder drejtesise, kreu IX;**

Gjate vitit 2019 eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal per **1 material kallezues.**

### **Vepra penale qe prekin sistemin e zgjedhjeve, kreu X;**



Gjate vitit 2019 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për **3 materiale kallezuese**.

Ne të gjitha rastet, në arsyetimin e vendimeve është bërë dhe orientimi i personave të demtuar apo kallezuesve për t'ju drejtuar Gjykatës për raste konkrete me padi civile, apo ankim direkt në Gjykatë sipas nenit 59 të K.Pr.Penale.

Ne të gjitha rastet e mosfillimit të çështjeve janë bërë njoftimet e vendimeve të mosfillimit paleve të interesuara gjë që evidentohet si nga korespondenca e shkresës ashtu dhe kopjet e vendimeve të konfirmuara dhe të administruara në fashikujt përkatës, ndërsa nuk ka pasë raste të ankimit të vendimeve të mosfillimit në gjykatë.

Duhet evidentuar fakti se një pjesë e madhe e kallzimeve për të cilat është vendosur mosfillimi, janë kryer verifikime faktesh rrethanash apo administrim dokumentash, duke argumentuar plotësisht shkaqet e mosfillimit.

- Pra referuar evidencës se mesipërme rezultoi se është bërë një punë e mirë dhe çështje në lidhje me trajtimin e materialeve fillestare, ku nuk rezultojnë ankime të vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimeve penale.
- Duhet evidentuar fakti se është respektuar afati 15-ditor (*sipas ndryshimeve ligjore me ligjin nr.35/2017*)
- Po ashtu duhet evidentuar se rezultojnë referime të akteve me mangësi (të dukshme) nga policia gjyqësore, apo raste të konflikteve të pronësive që kanë të bëjnë me administrim të praktikave administrative apo gjyqësore për të bërë një konkludim të saktë në vendim, si dhe vonesat në konfirmimet e akteve të ekspertimit mjeko-ligjor, gjë që ka bërë që në disa raste të urdherohet regjistrimi i materialeve kallezuese, në pritje të administrimit të akteve të ndryshme.

### **III. ÇESHTJE PENALE TË REGJISTRUARA DHE HETUARA.**

- Në vitin 2019 janë regjistruar gjithsej **182 procedime penale**.
- Janë mbartur nga vitit 2018, **60 procedime penale**.
- Ka ardhur me transferim nga prokurori e tjera **1 procedim penal**.
- Janë rifilluar hetimet për procedimet penale të pezulluara për **61 procedime penale** të viteve të mëparshme, të cilat janë rifilluar për efekt të parashkrimit të ndjekjes penale.
- Pra për vitin 2019 rezultojnë gjithsej të hetuara **303 procedime penale**.
- Kanë perfunduar hetimet gjithsej për **244 procedime penale**.
- Kanë mbetur në hetim pa perfunduar **59 procedime penale**.

Gjate vitit 2019 ka pasë rritje të numrit të procedimeve penale të regjistruara krahasuar me vitin 2018 dhe konkretisht gjate vitit 2019 bashkë me procedimet e ardhura me transferim janë regjistruar 182 procedime penale, ndërsa gjate vitit 2018, bashkë me procedimet penale të ardhura me transferim kanë qenë të regjistruara 208 procedime penale me diferencë prej 26 procedime penale. Po ashtu nga numri total i procedimeve penale të hetuara rezultoi se gjate vitit 2019 ka patur një rritje të numrit të procedimeve penale të hetuara dhe konkretisht në vitin 2018 janë hetuar gjithsej 370 procedime penale, ndërsa në vitin 2019 janë hetuar gjithsej 303 procedime penale, (67 procedime penale më pak se gjate vitit 2018).



### Evidence e çeshtjeve te regjistruara dhe hetuara

Viti	Mbartur nga viti para -ardhes	Regjistruar	Gjithsej Hetuar	Perfunduar
2018	112	258	370	310
2019	60	243	303	244

### DREJTIMET, SHTRIRJA DHE TENDENCAT E PERHAPJES SE VEPRAVE PENALE NE PERGJITHESI DHE /OSE GRUP VEPRAVE PENALE NE VECANTI.

Sa i perket tendences se natyres kriminalitetit, te perhapjes se veprave penale ne pergjithesi apo me grup veprash penale te vecanta rezulton se veprat penale me nje shtrirje dhe perhapje me te madhe jane ato te :

#### Veprat penale te drejtuara kunder jetes se personit dhe shendetit kreu II.

Gjate vitit 2019 jane rregjistruar 11 procedime penale, jane mbartur nga vitit 2018 4 procedime penale dhe jane rifilluar 1 procedim penal, gjithesej hetuar gjate vitit 2019 16 procedime penale.

- **Rregjistruar gjate vitit 2019 gjithesej 11 procedime penale;**
- **Mbartur nga vitit 2018, 4 procedime penale;**
- **Rifilluar gjate vitit 2019, 1 procedim penal;**

#### Vepra penale kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike kreu III.

Gjate vitit 2019 jane rregjistruar 95 procedime penale, jane mbartur nga vitit 2018, 33 procedime penale dhe jane rifilluar 50 procedim penal, gjithesej hetuar gjate vitit 2019, 178 procedime penale.

- **Rregjistruar gjate vitit 2019 gjithesej 95 procedime penale;**
- **Mbartur nga vitit 2018, 33 procedime penale;**
- **Rifilluar 50 procedim penale**

#### Vepra penale kunder mjedisit, kreu IV;

Gjate vitit 2019 jane rregjistruar 9 procedime penale, jane mbartur nga vitit 2018, 7 procedime penale dhe jane rifilluar 1 procedim penal, gjithesej hetuar gjate vitit 2019, 17 procedime penale.

- **Rregjistruar gjate vitit 2019 gjithesej 9 procedime penale;**
- **Mbartur nga vitit 2018, 7 procedime penale;**
- **Rifilluar 1 procedim penal.**

**Vepra penale kunder autoritetit te shtetit, kreu VIII;**

Gjate vitit 2019 jane rregjistruar 64 procedime penale, jane mbartur nga vitit 2018, 15 procedime penale dhe jane rifilluar 9 procedim penal, gjithesej hetuar gjate vitit 2019, 88 procedime penale.

- **Rregjistruar gjate vitit 2019 gjithesej 64 procedime penale;**
- **Mbartur nga vitit 2018, 15 procedime penale;**
- **Rifilluar 9 procedim penale**

**Vepra penale kunder drejtesise, kreu IX;**

Gjate vitit 2019 eshte rregjistruar 1 procedim penal dhe eshte mbartur nga vitit 2018, 1 procedim penal, gjithesej hetuar gjate vitit 2019, 2 procedime penale.

- **Rregjistruar gjate vitit 2019 gjithesej 1 procedime penale;**
- **Mbartur nga vitit 2018, 1 procedime penale;**

**Vepra penale qe prekin sistemin e zgjedhjeve, kreu X;**

- Gjate vitit 2019 eshte rregjistruar 1 procedim penal. Gjithesej ne hetim 1 procedim penal.

**IV. MENYRA E PERFUNDIMIT TE ÇESHTJEVE.**

*( Personat ne hetim, masa sigurimit, pushimet, pezullimet dhe te derguara per gjykim)*

Kane perfunduar hetimet dhe eshte konkluduar ne vendim perfundimtar per 244 çeshtje penale per vitin 2019, duke mbartur ne hetim 59-çeshtje penale per vitin 2020.

Rezulton se nga 244 - **çeshtje te perfunduara:**

- **64 - çeshtje jane derguar per gjykim,**
- **113 -çeshtje jane pushuar, nga keto 61 çeshtje te riflluara dhe pushuar per efekt te parashkirit te ndjekjes penale.**
- **63- çeshtje jane pezulluar,**
- **4-çeshtje jane transferuar per kompetence,**
- **59- çeshtje jane mbartur per vitin 2020.**

Tabele permbledhese

							Mbartur ne hetim
--	--	--	--	--	--	--	------------------



Mbartur nga 2018	Regjistruar dhe rifilluar ne 2019	Hetuar	Gjygjtit	Pushuar	Pezulluar	Transferuar	ne - 2018
60	243	244	64	113	63	4	59171

### **PERSONA NEN HETIM, DHE MASAT E SIGURIMIT**

#### **Regjistruar emri si person nen hetim.**

Ne keto procedime penale rezulton se eshte regjistruar emri per 137 - persona me cilesine e te dyshuarit per nje veper penale ne urdherin e regjistrimit, pra me cilesine ndaj te cileve zhvillohen hetime.

Nga keta kane perfunduar hetimet per 105 - persona,

- ku 81-personave u jane njoftuar akuzat perkatese njoftimit te akuzes neni 34 K.Pr.P“ dhe jane derguar per gjykim,
- per 5 - persona nen hetim eshte vendosur transferimi i procedimeve penale,
- per 19 - persona eshte vendosur pushimi i ceshtjes penale ne ngarkim te tyre,
- per 32 - persona nen hetim jane mbartur per vitin 2020.

#### **Masat e sigurimit .**

- Jane arrestuar ne flagrante nga policia gjyqesore 23 persona te dyshuar per kryerjen e veprave penale.
- Jane ndaluar me urdher te prokurorit 6 te dyshuar per kryerjine e vprave penale.
- Gjithesej te arrestuar/ndaluar kane qene 29 persona te dyshuar per kryerjen e veprave penale.
- Jane kerkuar ne gjykate vendosja e mases se sigurimit arrest ne burg ne mungese per 2 persona te dyshuar per kryerjen e veprave penale.
- Rezulton se ka te njejten numer te personave te arrestuar/ndaluar ne krahasim me vitin 2018 gjate se cilit jane arrestuar/ndaluar 30 persona, ndersa ne vitin 2019 jane arrestuar/ndaluar 29 persona te dyshuar per kryerjen e veprave penale.
- Eshte kerkuar **vleftesimi** i arrestit ne flagrante dhe ndalimit per 29- persona te dyshuar.
- Gjykata per 29 - raste ka vleftesuar te ligjshem arrestimet/ndalimet.

**Nga Prokuroria eshte kerkuar caktim mase sigurimi 29 -persona te dyshuar te arrestuar/ndaluar dhe 2 persona ne mungese, eshte kerkuar masa e sigurise si me poshte :**

- 17-te dyshuar eshte kerkuar masa e sigurimit “arrest ne burg“ sipas nenit 238 te K.Pr.Penale,
- 2-te dyshuar “arrest ne shtepi” sipas nenit 237 te K.Pr.Penale,



- 10-te dyshuar masa e sigurimit “Detyrim per tu paraqitur ne Pol/Gjyqesore“ sipas nenit 234 te K.Pr.Penale.
- Per 2- te dyshuar masa e sigurimit “arrest ne burg ne mungese“.

**Nga Gjykata eshte vendosur caktim mase sigurimi per :**

- 11 - persona “arrest ne burg”,
- 5 - persona “arrest ne shtepi”,
- 3- persona “arrest ne burg me afat”,
- 10 - persona masa e sigurimit “detyrim per tu paraqitur ne Pol/Gjyqesore”.
- 2 -persona masa e sigurimit “arrest ne burg”, ne mungese.

Jane apeluar 2 vendime te gjykates per zbutjen e mases se kerkuar nga prokurori.

Jane ushtruar 3 ankime kundershuese ndaj vendimeve te gjykates per masa te sigurimit.

Per 2- raste gjykata e apelit ka mbeshtetur kerkesen e prokurorit, ndersa per 3–raste gjykata ka dhene vendime qe rrezojne kerkesat e prokurorit per masa sigurimit, duke zbutur masat e sigurimit.

**a) CESHTJE TE DERGUAR NE GJYKATE**

- Pas perfundimit te hetimeve jane derguar per gjykim prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tropoje 64-procedime penale, me 81 - te pandehur, nder te cilet 24 me masa sigurimi.
- Jane mbartur ne gjykim nga vitit 2018, 40 procedime penale me 43 te pandehur, nder te cilat me 5 te arrestuar.
- Kane qene ne gjykim gjithesej gjate vitit 2019, 104 procedime penale, me 124 te pandehur, nder te cilet 29 me masa sigurimi.

**Duke ju referuar veprave penale per te cilen jane akuzuar e derguar per gjykim te pandehurit, rezulton si me poshte :**

**Veprat penale te drejtuar kundër jetes se personit dhe shendetit kreu II.**

-Gjate vitit 2019;

- Derguar per gjykim 6 procedime, me 6 te pandehur, me 6 te arrestuar.
- Mbartura ne gjykim nga vitit 2018, 3 procedime penale; me 3 te pandehur, me 2 te arrestuar.
- Gjithesej ne gjykim 9 procedime penale me 9 te pandehur, me 8 te arrestuar

**Vepra penale kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike kreu III.**

-Gjate vitit 2019;

- Derguar per gjykim 34 procedime, me 39 te pandehur, me 6 te arrestuar.
- Mbartura ne gjykim nga vitit 2018, 26 procedime penale; me 28 te pandehur.
- Gjithesej ne gjykim 60 procedime penale, me 67 te pandehur, me 7 te arrestuar



#### **Vepra penale kunder mjedisit, kreu IV;**

Gjate vitit 2019;

- Derguar per gjykim 3 procedime, me 3 te pandehur.
- Mbartura ne gjykim nga vitit 2018, 1 procedim penale, me 1 te pandehur.
- Gjithesej ne gjykim 4 procedime penale, me 4 te pandehur.

#### **Vepra penale kunder autoritetit te shtetit, kreu VIII;**

-Gjate vitit 2019;

- Derguar per gjykim 19 procedime, me 25 te pandehur, me 12 te arrestuar.
- Mbartura ne gjykim nga vitit 2018, 8 procedime penale, me 9 te pandehur, me 3 te arrestuar.
- Gjithesej ne gjykim 27 procedime penale, me 34 te pandehur, me 15 te arrestuar

#### **Vepra penale kunder drejtesise, kreu IX;**

-Gjate vitit 2019;

- Derguar per gjykim 1 procedime, me 1 te pandehur.
- Mbartura ne gjykim nga vitit 2018, 1 procedime penal, me 1 te pandehur.
- Gjithesej ne gjykim 2 procedime penale me 2 te pandehur.

#### **Vepra penale qe prekin sistemin e zgjedhjeve, kreu X;**

- Gjate vitit 2019 eshte derguar per gjykim 1 procedim penal me 6 te pandehur.

#### **Forma e gjykimit.**

- Jane derguar gjykates kerkest per miratimin e urdherit penal per 2 procedime penale dhe gjykata ka vendosur miratimin e urdherit penal per 2 procedime penale.
- Jane derguar gjykates kerkest per miratimin e marrveshjes se pranimit te fajesise per 10 procedime penale dhe gjykata ka vendosur miratimin e marrveshjes per 10 procedime penale.
- Jane derguar ne gjykate kerkesat per dergimin e ceshtjes ne gjyq per 59 procedime penale dhe gjykata ka vendosur pranimin e kerkeses per 38 ceshtje penale, per 1 ceshtje penale gjykata ka vendosur pushimin e ceshtjes, ndersa 20 ceshtje penale jane ne fazen e gjykimit paraprak.

#### **b) *CESHTJE PENALE TE PERFUNDUARA GJYKIMI PER VITIN 2019***

- Gjate vitit 2019 pas dergimit te ceshtjeve penale per gjykim, ka perfunduar gjykimi per 77-procedime penale, me 84-te pandehur, nga te cilet 27-te pandehur me mase sigururimi.
- Kane mbetur ne gjykim 27 procedime penale, me 40 te pandehur me 3 te arrestuar.

#### **Nga Prokuroria :**



- Per 7 te pandehur eshte kerkuar denimi me gjobe.
- Per 1 te pandehur denimi ne minimum te dispozites.
- Per 14 te pandehur denim mesatare te dispoiztes.
- Per 1 te pandehur denim ne maksimum.
- Per 60 te pandehur eshte kerkuar pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim ( neni 59 K.Penal).
- Per 1 te pandehur eshte kerkuar pushimi i çeshtjes.

#### Nga Gjykata ;

- Per 7 te pandehurui eshte kerkuar denimi me gjobe.
- Per 3 te pandehur denimi ne minimum te dispozites.
- Per 12 te pandehur denim mesatare te dispoiztes.
- Per 1 te pandehur denim ne maksimum.
- Per 59 te pandehur eshte kerkuar pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim ( neni 59 K.Penal).
- Per 2 te pandehur gjykata ka vendosur pafajesi.

Jane apeluar vendimet e gjykates per 3 vendime per te cilat gjykata ka dhene mase me te bute denimi si dhe per 1 vendim per pafajesi.

Po ashtu eshte ushtruar ankim kundershues ndaj 8 ankimeve te pandehurve per mase denimi apo dhe vendime denimi.

Evidentojme faktin qe nje pjese e madhe e denimeve me kusht (pezulluar ekzekutimin e denimit me burg neni 59 K.P) dhe detyrimet per te bere nje pune me interes publik (neni 63 te K.P) kane te bejne me vepra penale te parashikuara nga nenet 291 dhe 199/a/1 te K.Penal, 199/a, si dhe vepra te tjera te lehta penale.

Siç shikohet nga statistika e mesiperme raporti i kerkesesave per mase denimi te Prokurorise me vendimet e dhena nga Gjykata rezulton nje raport pa ndryshime thelbesore si ne llojin ashtu dhe ne masen e denimit.

Ne kete veshtrim jane analizuar dhe qendrimet per apelim me kete raport ndryshimesh te kerkesave dhe dhenies se vendimeve.

Po ashtu per shkak se Gjykata e Shkalles se Pare Tropoje mbulon ne juridiksionin e saj I.E.V.P Tropoje, rezulton se nga ana e prokuroreve jane trajtuar ne gjykim 10 – kerkesa me objektet kerkesa sipas neneve 64 – 59/a/ te K.Penal.

Evidentojme dhe 61-kerkesa per pushimin e çeshtjeve me parashkrim sipas nenit 66/ te K.Pr.Penale,( pas ndryshimeve ligjore te dates 01.08.2017).

### Ankimet ne Gjykatën e Apelit



Jane apeluar vendimet e gjykates per 3 vendime per te cilat gjykata ka dhene mase me te bute denimi si dhe per 1 vendim per pafajesi.

Po ashtu eshte ushtruar ankim kundershgues ndaj 8 ankimeve te pandehurve per mase denimi apo dhe vendime denimi. Nga Gjykata e Apelit Shkoder, nuk jane pranuar kerkesat e te pandehurve per zbutjen e masave te denimit apo pafajesi.

Jane apeluar 2 vendime te gjykates per zbutjen e mases se kerkuar nga prokurori.

Jane ushtruar 3 ankime kundershgues ndaj vendimeve te gjykates per masa te sigurimit.

Per 2- raste gjykata e apelit ka mbeshtetur kerkesen e prokurorit, ndersa per 3-raste gjykata ka dhene vendime qe rrezojne kerkesat e prokurorit per masa sigurimit, duke zbutur masat e sigurimit.

### **c) PROCEDIMET PENALE TE PUSHUARA**

Gjate ketij viti nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tropoje eshte vendosur pushimi per 113-procedime penale me 19- persona nen hetim.

Nga keto duhen veçuar se 61 procedime penale jane procedime te viteve te meparshme te friflluara dhe te pushuara apio paraqitur kerkeese ne gjykate per pushimin e hetimeve per shkak te parashkrimit te ndjekjes penale.

- Per 23 – çeshtje eshte vendosur pushimi ne Prokurori (kundravajtjet penale, dhe me heqje dore)
- Per 90 – çeshtje eshte kerkuar miratimi i kerkeses per pushim ne Gjykate. Nga keto per 72 – çeshtje gjykata ka vendosur miratimin e kerkeses per pushim, ndersa per 6-çeshtje ka vendosur kthimin e akteve ne Prokurori, ndersa per 12-çeshtje jane ne faze gjykimi paraprak.
- Per 6 – çeshtje nuk eshte miratuar kerkesa per pushim nga Gjykata, dhe jane kthyer per ri-hetime. (2- çeshtje jane ri-derguar perseri per pushim, ndersa 4-çeshtje jane ne hetim)

#### **Duke ju referuar statistikes rezulton se :**

Per 40-procedim penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/a (fakti nuk ekziston) te K.Pr.Penale.

Per 7-procedim penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/dh te.K.Pr.Penale (per mungese provash).

Per 5 - procedime penale eshte vendosur pushimi ne baze te nenit 328/c – 286 K.Pr.Penale (heqja dore nga ankimi) kryesisht per nenet 275, 89, 84 K.P.

Per 61 procedime penale jane pushuar hetimet per shkak te parashkrimit te ndjekjes penale.

Duke ju referuar grup veprave penale per te cilat eshte rregjistruar procedimi rezulton se eshte vendosur pushimi si me poshte :

#### **Duke ju referuar veprave penale per te cilen jane pushuar hetimet, rezulton si me poshte :**

##### **Veprat penale te drejtuara kunder jetes se personit dhe shendetit kreu II.**

- Pushuar hetimet per 2 procedime penale.

##### **Vepra penale kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike kreu III.**



- Pushuar hetimet 80 procedime penale. (se bashku me procedime penale te pushuar per efekt te parashkrimit te ndjekjes penale).

**Vepra penale kunder mjedisit, kreu IV;**

- Pushuar hetimet per 2 procedime penale.

**Vepra penale kunder autoritetit te shtetit, kreu VIII;**

-Gjate vitit 2019;

- Pushuar hetimet per 28 procedime penale.

**Vepra penale kunder drejtesise, kreu IX;**

- Pushuar hetimet per 1 procedim penal.

Dosjet e pushuara kane qene kryesisht per vepra penale te parashikuara nga nenet 290/1, 275, 150, 151 te Kodit Penal, si dhe 61 dosje te pushuar per shkak te parashkrimit te ndjekjes penale. Po ashtu duhet theksuar si problematike per dojset e pushuara se per shkak te largesise me Tiranen si dhe mungeses se shume eksperteve te fushave te ndryshme ne Tropoje shume here jemi te detyruara te rregjistrojme procedime penale te cilat ne momentin e rregjistrimit nuk mund te konstatohet se veprimi ose mosveprimi i ploteson elementet e vepres penale pa kryer me perpara ekspertimet perkatese teknike kriminalistike, siç jemi perpara rastit te veprave penale ne fushen e shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugore, mjekesise ligjore, etj. Per shkak te largesise, voneses ne kthimin e akteve te ekspertimit dhe mungeses se eksperteve mjekoligjore dhe te tjere, jemi te detyruar te rregjistrojme procedimin penal pasi deri ne ardhjen e aktit te ekspertimit kalojne afatet per te vendosur mosfillimin e procedimit penal. Po ashtu nje pjese e mire e procedimeve penale jane procedime te rregjistruara per vepra penale qe ndiqen mbi bazen e ankimit te demtuarit te cilet me pas kane terhequr ankimin e bere nga ana e tyre.

**d) PROCEDIMET PENALE TE PEZULLUARA**

Eshte vendosur pezullimi i hetimeve ne baze te nenit 326/1,2 te K.Pr.Penale per 63- procedime penale te cilat jane te ndara me grup veprash:

**Duke ju referuar veprave penale per te cilen jane pezulluar hetimet, rezulton si me poshte :**

**Veprat penale te drejtuara kunder jetes se personit dhe shendetit kreu II.**

- Jane pezulluar hetimet per 4 procedime penale

**Vepra penale kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike kreu III.**

- Jane pezulluar hetimet per 59 procedime penale.

Procedimet penale te pezulluara jane kryesisht per veprat penale te parashikuara nga nenet 134, 284 dhe 275 te Kodit Penal.

Ne te gjitha rastet eshte urdheruar kryerja e veprimeve hetimore si dhe deleguar veprime specifike, dhe ne perfundim bazuar dhe ne relacionin e oficereve te policise gjyqesore eshte vendosur pezullimi i hetimeve.



Ne kuptimin e figurave te krimi te ketyre grup veprave penale duhet nenvizuar se per nenin 134/ te K.Penal rezulton pjesa me e madhe e tyre.

e) **PROCEDIMET PENALE TE TRANSFERUARA**

Eshte vendosur trasferimi per kompetence tokesore dhe lendore per 5 - procedime penale nga te cilet 3 procedime penale jane per kompetence lendore Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se pare Shkoder (seksionit te miturve), dhe 1 procedim penal per vepren penale te parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal eshte transferuar per kompetence lendore ne SPAK.

Ka pase nje rast te shpalljes se moskompetecnes nga prokurori i cili pas trajtimit te konfliktit te kompetences, Prokurori i Pergjithshem ka vendosur kthimin per hetim per kompetence ne Prokurorine Tropoje.

Pra evidentojme faktin qe vendimet kane qene te arsyetuara dhe te bazuara ne dispozitat proceduriale per kompetencen.

**IV. SHPEJTESIA ME HETIMET PARAPRAKE DHE AFATET E PARABURGIMIT**

Nga treguesit kryesor te veprimtarise se punes se Prokuroreve dhe trupes se of/pol/Gjyqesore te Prokurorise dhe sherbimeve prane Komisarariatit te Policise Tropoje, eshte shpejtesia e veprimeve hetimore ne hetimet paraprake e cila ka te beje ne respektimin e dispozitave proceduriale penale per afatet e hetimit dhe ne veçanti ato te paraburgimit me te pandehur te arrestuar .

Rezultun se pergjithesisht jane respektuar kriteret e afateve te hetimit.

Rezultun se gjate hetimeve paraprake eshte kerkuar zgjatja afati hetimor per 35- **çeshtje penale nga 370-çeshtje te hetura gjithsej.**

Konkretisht eshte kerkuar zgjatje e afatit te hetimit per:

- 10-procedime zjatje afati deri ne 3 muaj,
- 1-procedime deri ne 6 muaj.
- 3 –procedimi nga 6-9 muaj.
- 1- procedim penal deri ne 1-vit.
- 2-procedime penale mbi 1- vit.

Ne lidhje me afatet e paraburgimit nuk ka asnje rast te kalimit te ketyre afateve , per rrjedhoje nuk kemi asnje kerkese drejtuar Gjykates per zgjatjen e afatit te paraburgimit.

Duhet evidentuar fakti se jo rralle zgjatjet jane vendosur per shkak te zvarritjes se veprimeve nga sherbimet e pol.gjyqesore te cilat kane relatuar me vonese per dinamiken dhe gjendjen e hetimeve. Po ashtu duhet evidentuar se per shkak te zevendesimet e shpeshta te oficereve te policise gjyqesore ne seksionin e policise se shtetit kane sjelle per pasoje kryerjen e veprimeve hetimore me vonese dhe si shkak i saje eshte vendosur dhe zgjatja e afatit te hetimeve.



## **V. EKZEKUTIMI I VENDIME PENALE**

Gjate vitit 2019, jane nxjerre nga prokuroret 57 urdhera per ekzekutimin e vendimeve penale te gjykates per masa denimi dhe 4 urdhera per ekzekutimin e denimeve plotesuese, te dhena nga Gjykata e Rrethit Gjyqesore Tropoje.

Nga keto 6 - urdhera ekzekutimi te denimit me burgim, 5- urdhera denimi me gjobe, 46- urdhera ekzekutimi per denime alternative, si dhe 4 urdhera ekzekutimi per denime plotesuese.

Jane ekzekutuar 6-urdhera ekzekutimi per denime me burgim, 46 -urdhera ekzekutimi te denimeve alternative, 2 urdhwera ekzekutimi te denimeve alternative.

Ne te gjitha rastet eshte urdheruar dhe ekzekutimi i shpenzimeve procedurale.

## **VI. Veprimtaria dhe ngarkesa e Prokuroreve dhe Of/Pol/Gjyqesore.**

Por per te qartesuar veprimtarin, punen individuale per çdo Prokuror dhe Of/Pol/Gjyqesore po paraqesim dhe treguesit per secilin ne veçanti :

### **Prokurori Artan Shtrungza**

Hetuar -	121- proçedime penale
Mosfillime –	25- kallzime
Derguar ne gjyq –	28 -proçedime penale
Pushuar –	20- proçedime penale
Pezulluar –	31 -proçedime penale
Transferuar -	1 -proçedim penal
Mbartur -	40- proçedime penale

### **Prokurori Artur Ismajlukaj**

Hetuar -	108- proçedime penale
Mosfillime –	41 -kallzime
Derguar ne gjyq –	33 -proçedime penale
Pushuar –	20 -proçedime penale
Pezulluar –	33 -proçedime penale
Transferuar -	3- -proçedime penale
Mbartur -	19 -proçedime penale

### **Prokurori Agim Dalipaj**

Hetuar -	13- proçedime penale
Mosfillime –	22 -kallezime
Derguar ne gjyq –	2-proçedime penale
Pezulluar –	3 -proçedime penale
Mbartur -	8 -proçedime penale



Gjate veprimtarise se punes se Prokuroreve duhet evidentuar si ngarkese dhe procedimet penale per te cilat eshte vendosur pushimi per shkak parashkrimi gjithsej 61- vendime pushimi per shkak parashkrimi sipas nenit 66/ te K.Penal.

Duhet evidentuar dhe ngarkesa e **Of/Pol/Gjyqesore te seksionit te Prokurorise Tropoje** e cila eshte perballuar nga Oficeri i Policise Gjyqesore Elton Hoxha.

**Of/Pol/Gjyqesore Elton Hoxha ka hetuar** 73 - ceshtje penale.

- Ka relatuar per dergim per gjykim 26 procedime penale.
  - Ka relatuar per pezullim 6 dosje penale.
  - Ka relatuar per pushim 20 dosje penale.
  - Ka perfudnuar 52 procedime penale.
- Ka mbartur ne hetim 21 dosje penale.

**Of/Pol/Gjyqesore seksioni i policise se shtetit Artur Hykaj ka hetuar** 20 - ceshtje penale.

- Ka relatuar per dergim per gjykim 4 procedime penale.
- Ka relatuar per pezullim 4 dosje penale.
- Ka relatuar per pushim 7 dosje penale.
- Ka relatuar per moskompetence 2 procedime penale.
- Ka perfunduar hetimet per 27 procedime penale.
- Ka mbartur ne hetim 5 procedime penale.

**Of/Pol/Gjyqesore seksioni i policise se shtetit Visar Ismalaj ka hetuar** 32 - ceshtje penale.

- Ka relatuar per dergim per gjykim 10 procedime penale.
- Ka relatuar per pezullim 14 dosje penale.
- Ka relatuar per pushim 3 dosje penale.
- Ka perfunduar hetimet per 17 procedime penale.
- Ka mbartur ne hetim 3 dosje penale.

**Of/Pol/Gjyqesore seksioni i policise se shtetit Fatos tahiri ka hetuar** 30 - ceshtje penale.

- Ka relatuar per dergim per gjykim 7 procedime penale.
- Ka relatuar per pezullim 13 dosje penale.
- Ka relatuar per pushim 3 dosje penale.
- Ka perfunduar hetimet per 23 procedime penale.
- Ka mbartur ne hetim 7 dosje penale.

## **VII. Ekstradimet dhe Leter-porosite**

Nje tjeter veprimtari qe duhet evidentuar jane dhe kerkesat per ekzekutimin e leterporosive per marrjen e provave si dhe kerkesat per ekstradimin e personave te denuar apo dyshuar.



Konkretisht rezulton se jane arrestuar 2 persona te shpallur ne kerkim nga autoritetet kosovare te drejtewise te cilet pas kryerjes se veprimeve procedurale dhe gjyqesore perfundimisht gjykata ka vendosur ekstradimin e tyre dhe ne perfundim te procesit eshte realizuar ekstradimi.

Jane ekzekutuar 12 leterporosi nga jashte per marrjen e provave, ndersa eshte kerkuar marrja e provave nepermjet leterporosise per 2 raste lidhur me nevojat e procedimeve penale.

Eshte paraqitur ne gjykate 1 kerkese per njohjne e vendimit penal te huaj, kerkese e cila ehste pranuar nga gjykata.

### **VIII. USHTRIMI I ROLIT DHE KOMPETENCAVE TE DREJTUESIT TE PROKURORISE.**

Ne veprimtarine e ndjekjes penale per ceshtjet e hetuara dhe te perfaqesuara ne gjykim, nje rol luan dhe ushtrimi i kontrollit nga Drejtuesit e Prokurorise, qe nga momenti i pare i vleresimit te akteve te referuara per problemikat e rasteve drejtim regjistrimit te ceshtjeve penale, me pas te kontrollit ne dinamike, analizave per ratet e diferencuara, si dhe krijimit te marredhenieve me Prokuroret dhe Of/Pol/Gjyqesore, te seksionit te Prokurorise dhe seksioneve dhe sherbimeve te Policise, si dhe me Institucionet e tjera .

Gjate periudhes qe analizojme nga Drejtuesi i Prokurorise jane studiuar te gjitha materialeve kallzuese dhe te referuara nga Policia Gjyqesore e ato me vendngjarje, duke organizuar punen per regjistrimin e ceshtjeve.

Urdherat dhe udhezimet e Zyres se Prokurorit te Pergjithshem, jane punuar dhe diskutuar per implementimin e tyre.

Eshte ushtruar kontroll ne dinamike te ceshtjeve penale gjate hetimeve paraprake, jane evidentuar dhe kerkuar verbalisht veprime konkrete qe duhet te kryhen.

Konkretisht eshte krijuar nje klime e mire bashkepunimi ne perballimin e ngarkeses, ndarjen e ceshtjeve sipas shortit, duke respektuar proporcionalitetin, dhe ne raste te vecanta per shkak ngarkese apo profilizimi te caktuar Prokurore te ndryshem jane ngarkuar me ceshtje te vecanta.

Referuar urdherave dhe udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem, jane nxjerre disa urdhera dhe udhezime nga Drejtuesi i Prokurorise. Konkretisht

Urdheri nr. 15 dt. 20.04.2018 “per organizimin e seksionit te miturve.”

Udhezimi nr. 23 dt. 05.11.2018 “Per pergjimet”.

Udhezimi nr. 24 dt. 05.11.2018 “Per vleresimin administrimin dhe ruajtjen e informacionit te klasifikuar sekret shteteror”.

Udhezimi nr.25 dt. 26.11.2018 “Per hetimin pasuror dhe konfiskimin e produkteve te vepres penale”.

### **IX. MARREDHENIET ME INSTITUCIONET**

Se pari raporti ligjor dhe korrektesia, ka shoqeruar marredheniet me Institucionet e tjera ligjzbatuese, ne vecanti me sherbimet e Komisarjatit te Policise Tropoje, si dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqesore Tropoje, Prokurorine prane Gjykates se Apelit Shkoder.



Marredheniet qe burojne per shkak te veprimtarise dhe procedurave ligjore, te hetimit dhe perfaqesimit ne gjygj, pra me Policine dhe Gjykatën, jane vleresuar si marredhenie bashkepunimi si ne aspektin organizativ ashtu dhe ate ligjor ne respektim te kryerjes se detyrave ne afate nga seksionet e Pol/Gjyqesore dhe sherbimet, ashtu dhe respektimin dhe korrektesine ne zhvillimin e seancave gjyqesore me Gjykatën.

Ne disa raste eshte mbajtur qendrim per problematika te ndryshme, te karakterit organizativ te punes, pa cenuar pamvaresine e institucioneve.

### **1. GJYKATA**

Nuk jane evidentuar raste te shtyrjes se seancave gjyqesore per mosparaqitjen e Prokuroreve. Nga ana e gjykates duhet vleresuar bashkepunimi me prokuroret per perballimin e ngarkeses ne gjykim, si dhe organizmi i punes lidhur me njoftimin ne kohe te datave te seancave gjyqesore, marrjen dhe percjelljen ne kohe te dokumentacionit.

Disa raste me zvarritje te proceseve jane evidentuar per shkak te numrit te reduktuar te gjygtareve ne periudhen e 9 mujorit te pare, si dhe problematikave lidhur me komandimin e gjyqtareve nga rrethet e tjera.

### **2. ZYRA SHERBIMIT TE PROVES.**

Marredhenia e Prokurorise me zyren e sherbimit te proves, lidhet per shkak te trajtimit te rasteve te gjykimeve me objekt lirimet pra kohe me kusht, pra ekzekutimit te ketyre vendimeve.

Ne rastet e kerkuara nga prokuroret dhe Gjykata ne aplikimin e dhenies se denimeve me kusht sipas nenit 59 te K.Penal, pergjithesisht jane raportuar verifikimet me nje raport, i cili ka sherbyer me pas per te vleresuar kushtet dhe kriteret llojin e denimit, dhe ne 2-raste eshte kerkuar revokimi i denimit me kusht.

Verehen problematika ne ekzekutimin ne kohe te denimeve alternative dhe permbylljen e e raporteve perfundimtare te sherbimit te proves, kjo per shkak se per disa periudha kohe zyra e sherbimit te proves nuk eshte mbuluar me punonjes, per shak te largimeve nga puna apo doreheqjeve te punonjesve.

### **3. SHERBIMET E POLICISE**

Pergjithesisht eshte reflektuar nje nivel shume i mire bashkepunimi.

Eshte vleresuar si e rendesishme fazen e njoftimit te prokuroreve te gatshem sipas grafikut per vepra penale te karakterit te rende, por dhe te problematikave ligjore gjate veprimeve te para hetimore.

Per sa i perket luftes kunder kriminalitetit ka pase nje forcim te bashkepunimit me strukturat e policise se shtetit ne Komisariatin e Policise Tropoje dhe Drejtorine e Policise Qarkut Kukes, si dhe SHÇBA me qellim identifikimin e veprave penale, autoresise se tyre, kryrjen e veprimeve hetimore sa me te shpejta dhe efikase, identifikimin e fenomeneve te kriminalitetit, pjesemarrjen e prokurorit ne ngjarjet e renda kriminale dhe ato kur prania e tij eshte e domosdoshme, kryerjen e analizave te perbashketa ne lidhje me fenomene te caktuara kriminale sic jane ato te kultivimit te narkotikeve te cilat per vtin 2019 ej.



Ne lidhje me materialet e referuara, shpesh evidentohen dhe mangesi te karakterit formal por dhe procedural.

- Duhet ngritur niveli profesional i policise gjyqesore.
- Nga sektori i krimit ekonomik apo per vepra penale me natyre korruptive, rezulton se nuk ka referime per vepra penal ne kete fushe. Veprimet hetimore fillohen vetem ne rastet kur evidentohen nga te dhenat e derguara nga agjensite e tjera ligjzbatuese.
- Ne rastet e referimit te veprave penale lidhur me pastrimin e produkteve te vepres penale, materialet referohen shume te mangeta pa kryer verifikime lidhur me pasurine e personave te kallezuar apo tjetet.

#### **4. ZYRA E PROKURORIT TE PERGJITHSHEM**

Duhet evidentuar dhe marredheniet me Zyren e Prokurorit te Pergjithshem, ne funksion te zbatimit te urdherave dhe udhezimeve.

Evidentojme se nga nxjerrja e tyre kane gjetur zbatim dhe ndikuar ne mbarevajtjen e veprimtarise se Prokurorise ne hetimin e ceshtjeve dhe perfaqesimin ne gjykim, por dhe drejtim aspektit organizativ.

Duhet evidentuar fakti i nje bashkepunimi korrekt dhe me vlere per hetimet me zyren e S.P.M.T.Sh.I ne Prokurorine e Pergjithshme.

Duhet evidentuar fakti, se ne lidhje me korespondencat, transkriptimet, apo administrimin e CD, eshte krijuar nje praktike e mire.

Per çdo rast evidentohet sakte ne regjistrin perkates te pergjimeve.

Per kete ka sherbyer dhe udhezimi i Prokurorit te Pergjithshem "Per pergjimet".

Dhe me Drejtorine e Marredhenieve me Jashte, ka patur nje bashkepunim korrekt, por kete vit nuk ka patur nje numer te konsiderueshem praktikash.

#### **• ADMINISTRATA**

Ne mbarevajtjen e punes te veprimtarise se Prokurorise nje rol te rendesishem kryen dhe administrata e Prokurorise.

Duhet evidentuar se sa i perket zyres se regjistrit rezulton se jane mbajtur me korrektesi regjistrat perkates, jane derguar brenda afateve te percaktuara evidencat.

Zyra e K/sekretarise ka perballuar volumin e protokolleve si dhe mbajtur evidencat financiare.

Rezulton se tashme ka nje ngarkese sa i perket kesaj zyre, per shkak te mbulimit te tre sektoreve, si te protokullit, finances dhe Arshiven e Prokurorise, e cila tashme ka nje sistem te rregullt te evidentimit te dosjeve.

#### **X. DREJTIMET DHE PRIORITETET E PUNES PER VITIN 2020.**

Bashkepunimi nder-institucional me te gjitha axhensite ligjzbatuese, te luftes kunder krimi, eshte nje nder elementet kryesore te arritjes se suksesit, dhe rezultateve te evidentueshme.

Vleresimi i te gjitha materialeve qe referohen apo dhe informative qe vijne nga axhensite e ndryshme te sherbimeve inteligjente.

Rritja e nivelit profesional te Prokuroreve dhe Of/pol/Gjyqesore, nepermjet trajnimeve te ndryshme dhe te specializuara, qe do te ndikonte ndjeshem ne rritjen e cilesise se veprimtarise hetimore dhe perfaqesimit ne gjykime.

Rritja e ushtrimit te kontrollit ne dinamike te ceshtjeve nga Prokuroret, por dhe kryerja e veprimtarise hetimore nga ana e tyre.

Vleresimi i vecante per ceshtje te karakterit te rendesishem dhe sensitive ne menyre te diferencuar, duke kryer analiza te vleresimit te hetimeve dhe provave te administruara, duke lene detyra konkrete, si dhe duke kryer vete nga Prokuroret veprime hetimore.

#### **Prioritetet per vitin ne vazhdim 2020 :**

Ne veshtrim te prioriteteve te shpallura nga Keshilli i Ministrave per luften kunder kriminalitetit, bazuar ne progres raportet dhe rekomandimet e partnereve te huaj, si urdherave dhe udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem, duhen percakuar dhe prioritetet per vitin 2020 si me poshte :

- Angazhimi maksimal per hetimin dhe perfundimit e ceshtjeve te mbartura nga vitii 2019.
- Lufta kunder korrupsionit, dhe krimi ekonomiko-financiar, si nje nga prioritetet dhe detyrat paresore, te punes tone, dhe kerkesave te kohes.
- Evidentimi, vleresimi dhe hetimi i veprave penale te referuara apo te evidentuara kryesisht, qe lidhen me veprimtari korruptive, apo dhe te shperdorimit te detyres, te cilat kane te bejne me subjekte te administrates shteterore.
- Rritja e efikasitetit te ushtrimit te ndjekjes penale ndaj autoreve, qe dyshohen per vepra penale te natyres se trafikave dhe pastrimit te produkteve, e cila duhet kordinuar me sherbimet e policise dhe axhensite e tjera ligjzbatuese.
- Rritja e integritetit dhe pamvaresise se te Prokuroreve dhe Of/Pol/Gjyq, duke synuar permiresimin e veprimtarise, dhe motivimit tyre.

#### **DREJTUESI I PROKURORISE**

ARTAN SHTRUNGZA

